



Planuar / Dorezuar Planned / Delivered	04.11.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr. Prot Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6745/2022		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.817/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.817/2022 të datës 23.09.2022 të parashtruar nga ankuesit

të cilët me autorizim i përfaqëson Avokatja me adresë kundër organit të punësimit/Ministria e Financës Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.817/2022 e datës 23.09.2022 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesit, që të gjithë të punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datë 23.09.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 5631/2022 të regjistruar me numër A.nr.817/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore, për periudhën kohore 06.09.2017 deri me 06.09.2022 sipas Ligjit për Nënpunësit Civil, Ligjit për Paga dhe Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve. Këshilli, me datë 06.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 5631/2022 të regjistruar me numër A.nr.817/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 23.09.2022; Kërkesa me numër të protokollit 1913-6/2022 e datës 06.09.2022 e parashtruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Autorizimi i ankueses Akt emërim për me nr.prot.07/12 e datës 19.06.2012; Autorizimi i ankuesit Akt emërim për me nr.prot.11/12 e datës 27.06.2012; Autorizimi i ankuesit Akt emërim për me nr.prot.05/12 e datës 19.06.2012; Akt emërim për me nr.prot.746 i datës 08.06.2012; Autorizimi i ankuesit i datës 21.04.2021; Autorizim i Akt emërim për me nr.prot.174 i datës 08.02.2012; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.09.2022; Përgjigja në ankesë e dërguar përmes e-mailit të datës 05.10.2022 e regjistruar me numër të protokollit.5928; Akt emërimi poër me nr.prot.97 e datës 28.12.2017; Akt emërim për me nr.prot.96 e datës 28.12.2017; Akt emërim për me nr.prot.98 e datës 28.12.2017; Akt emërim për me nr.prot.115 e datës 28.12.2017; Lista e pagave për periudhën kohore 01.09.2017-30.09.2017 për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesëve, është e palejuar, sepse

Kolegji për Shqyrtimi dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesit, respektivisht ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 01.01.2012 është e punësuar në Ministrinë e Punës Sociale në pozitën "Këshilltar" në Zyrën Komunale të Punësimit në Viti, ankues sipas Aktit të Emërimit të datës 01.01.2012 është i punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në pozitën "Përgjegjës i Zyrës" në Zyrën Komunale të Punësimit në Viti, ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 01.01.2012 është i punësuar në Ministrinë e Punës Sociale në pozitën "Këshilltar" në Zyrën Komunale të Punësimit në Viti, ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 01.01.2012 është e punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në pozitën "Nëpunës për Informim" Qendra Regjionale e Punësimit-Gjilan dhe ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 01.01.2012 është i punësuar në Ministrinë e Punës Sociale në pozitën "Nëpunës i Pensioneve dhe Beneficioneve" në Qendrën Rajonale-Viti.

Kolegji i Këshillit, po ashtu ka konstatuar se në emër të ankuesve të përcaktuar si më lartë, avokat sipas autorizimit, me datë 06.09.2022 në emër të palëve të përfaqësuara ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për kompensimin material të ankuesve në emër të kompensimeve të përcaktuara me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ndërsa me datë 23.09.2022 po ashtu sipas autorizimit

Avokat \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet e njëjta ankimore për kompensim material dhe me kërkesën që Këshilli të obligojë punëdhënësin e ankuesëve që t'ua njoh të drejtën në kompensim material për periudhën kohore nga datat 06.09.2017 deri me datë 06.09.2022, bazuar në dispozitat ligjore që parasheh Ligji për Nëpunësit Civil, Ligji për Paga dhe Kontrata e Përgjithshme Kolektive.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesëve, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”, si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, konstaton se ankesa e ankuesëve e datës 23.09.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me ankesën e ankuesëve të datës 06.09.2022 ende nuk kishte vendosur apo nuk ka nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesit të parashtrojnë ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që institucioni punëdhënës sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka pasur afat kohor 45 (katërdhjetë e pesë) ditë, për trajtimin e kërkesës së ankuesve të datës 06.09.2022, ndërsa ankuesit ankesën në Këshill e kanë parashtruar me datë 23.09.2022 apo 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë pas parashtrimit të ankesës në institucion punëdhënës.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimi de Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesve e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.09.2022 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.”*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.817/2022

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesëve, Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
- Arkivit të KPMSHCK-së.

